# Sfidat e qëndrueshmërisë dhe ri-integrimit të të kthyerve dhe personave të zhvendosur

Nëntor - 2021

**Mohim përgjegjësie:**

*Ky nuk është një publikim i UNHCR-së. UNHCR-ja nuk është përgjegjëse për përmbajtjen e tij dhe as nuk e miraton domosdoshmërisht atë. Çdo pikëpamje e paraqitur është pikëpamje vetëm e autorit ose e botuesit, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNHCR-së.*

## PËRMBLEDHJE

Numri i kthimeve vullnetare mbetet i ulët dhe i ndikuar nga faktorë të ndryshëm si: gjendja pandemike, jostabiliteti politik - zgjedhjet parlamentare dhe lokale, ngecja në dialogun Beograd-Prishtinë dhe perspektiva e dobët ekonomike. Në disa nga të ashtuquajturat "lokacione të vështira" ka ende fërkime që ndikojnë të kthyerit e mundshëm dhe komunitetin pritës, për shkak të supozimeve për krime të pazgjidhura të luftës ose rasteve të personave të zhdukur, megjithëse edhe faktorët e tjerë luajnë rol, si për shembull mosmarrëveshjet e vazhdueshme pronësore dhe vjedhjet. Në vitin 2021, vetëm 305 persona ishin regjistruar si të kthyer në Kosovë, që është 16% më pak krahasuar me vitin paraprak.

Mekanizmat që kanë të bëjnë me kthimin në nivel lokal nuk janë duke i ndjekur siç duhet politikat e kthimit, ndërsa zyrat komunale për komunitete dhe kthim janë aktive vetëm në zona të caktuara, ku ka programe të kthimit të financuara nga donatorët. Projektet lehtësuese vazhdojnë të shënjestrojnë vetëm një grup komunash të përzgjedhura, kështu që ndihma për kthim në komunat e tjera është lënë anash. Ka raste që janë miratuar nga Komisioni Qendror i Rishikimit që në vitin 2011 dhe ende nuk kanë përfituar strehim.

Vetëm 5 komuna kanë plane komunale veprimi për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, ndërsa 13 komuna janë në proces të hartimit të tyre. Planet e miratuara komunale të veprimit mbeten të pabuxhetuara dhe atyre u mungon një qasje më proaktive e mbledhjes së fondeve nga donatorët për projekte të caktuara që promovojnë interesat e përbashkët të të kthyerve dhe komuniteteve pritëse. Ministria për Komunitete dhe Kthim është në proces të krijimit të sistemit të menaxhimit të rasteve, ndërsa Komisioni Qendror i Ankesave ende nuk është formuar nga Qeveria e Kosovës, e që është një organ i rëndësishëm për shqyrtimin e kërkesave të të kthyerve/personave të zhvendosur.

Të kthyerit që nuk kanë tokë, kryesisht nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, vazhdojnë të përbëjnë grupin më të cenueshëm të të kthyerve, për shkak se komunat e kanë problemin e posedimit të kufizuar të tokës komunale dhe sfidat legjislative në ndarjen e tokës komunale për raste individuale. Uzurpimi ilegal i pronës, përfshirë uzurpimin e serishëm të pronave të liruara, mbetet një nga sfidat më të mëdha për komunitetin serb të të kthyerve.

Shkalla e papunësisë në mesin e familjeve të kthyera mbetet shumë e lartë. Mungesa e arsimimit dhe mungesa e aftësive profesionale i përjashton të kthyerit nga angazhimi në një punësim të rregullt dhe të denjë. Ka edhe pengesa për punësimin në sektorin publik të cilat ndërlidhen me kriteret e kërkuara të arsimit adekuat, përvojës së mëparshme të punës të cilën ata nuk e kanë.

Shumë prej të kthyerve vullnetarë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian përballen me sfida, përfshirë ato që lidhen me të drejtën për arsimim. Pas një periudhe të gjatë të jetesës si të zhvendosur, shpesh në kushte të palakmueshme, të kthyerit shpesh e kanë të vështirë procesin e kthimit dhe riintegrimit. Nivel i ulët i arsimimit dhe analfabetizëm vërehen tek romët, ashkalitë dhe egjiptianët, edhe pse arsimi fillor në Kosovë është i detyrueshëm. E drejta për arsim ndikohet nga varfëria e thellë e këtyre komuniteteve, pasi nxënësit dhe prindërit e tyre vështirë se ia dalin të përballojnë furnizimet e nevojshme për ndjekjen e rregullt të shkollës.

Të kthyerit/personat e zhvendosur nuk janë të informuar për mekanizmat dhe procedurat ankimore në rast se ata diskriminohen gjatë marrjes së shërbimeve publike. Përveç kësaj, është vërejtur një njohuri e kufizuar në lidhje me Sistemin e Drejtësisë së Kosovës, Zyrën Komunale për të Drejtat e Njeriut, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas dhe rolin e Ombudspersonit.

Përgjithësisht, shqetësimet kryesore të mbrojtjes për të kthyerit kanë të bëjnë me strehimin, regjistrimin civil, arsimin dhe perspektivën e paqëndrueshme socio-ekonomike.

Raportet përfshijnë gjithsej 147 familje me 496 anëtarë që janë kthyer nga 1 korriku 2020 deri më 31 tetor 2021.

## TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

| | Grupi i Planifikimit të Popullsisë | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ashkali | | Egjiptian | | Romë | | Serbë | | Boshnjakë | | Malazezë | | Shqiptarë | | | |
| Regjioni | fam | ind | fam | ind | fam | ind | fam | ind | fam | ind | fam | ind | fam | ind | Gjithsej f/ind | |
| Pejë | 0 | 0 | 8 | 40 | 1 | 6 | 11 | 19 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 5 | **20** | **72** |
| Gjilan | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 17 | 79 | 247 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **81** | **264** |
| Prishtinë | 4 | 33 | 0 | 0 | 3 | 15 | 24 | 63 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **31** | **111** |
| Mitrovicë | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 19 | **6** | **22** |
| Prizren | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 10 | 7 | 18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | **8** | **28** |
| **Gjithsej** | **4** | **33** | **8** | **40** | **8** | **51** | **121** | **347** | **1** | **1** | **0** | **0** | **5** | **24** | **147** | **496** |

| AGDM | 0-4 | 5-11 | 12-17 | 18-59 | 60+ | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Meshkuj | 21 | 25 | 19 | 138 | 46 | 249 |
| Femra | 12 | 18 | 28 | 130 | 59 | 247 |
| **Gjithsej** | **33** | **43** | **47** | **268** | **105** | **496** |

## ZHVILLIMET LEGJISLATIVE/POLITIKE (NIVELI LOKAL/QENDROR)

Për sa i përket zhvillimeve legjislative gjatë vitit 2021, vetëm njëmbëdhjetë ligje janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa pesëdhjetë e gjashtë projektligje i janë shpërndarë Kuvendit. Në mesin e të gjitha këtyre ligjeve dhe projektligjeve, me interes për çështjet që shqetësojnë personat për të cilët kujdeset UNHCR janë:

Qeveria e Kosovës ka dorëzuar në Kuvendin e Kosovës Projektligjin nr.08/L-052 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare të Krahasimit dhe Verifikimit të Pronës. Është përgatitur projektligji me qëllim të adresimit të gjetjeve të Avokatit të Popullit (Raporti Nr. 551/2017) lidhur me zbatimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës (AKKVP), dhe për të përmbushur obligimet që dalin nga Strategjia Kombëtare për Të drejtat e pronësisë, për të adresuar informalitetin në shkallë të gjerë.

Po ashtu, Kuvendit të Kosovës i është shpërndarë Projektligji nr. 08/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas. Ligji i ndryshuar ka përfshirë kategori të reja të veçanta, përkatësisht viktimat e dhunës në familje, viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e dhunës seksuale përfshirë viktimat e ngacmimin seksual, viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, viktimat e mitura, fëmijët që jetojnë në institucionet e përkujdesit social. Një koment është dorëzuar përmes platformës konsultative me qëllim të përfshirjes më të mirë të personave nën mandatin e UNHCR-së.

Gjithashtu, Projektligji nr.08/L-011 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i propozuar nga Qeveria është në shqyrtim nga Kuvendi i Kosovës. Projektligji synon zgjatjen e afatit për shitjen e këtyre banesave dhe përfundimin e procesit brenda tre (3) viteve, përkatësisht deri në vitin 2023.

Ministria e Planifikimit Hapësinor pret ndryshimin e ligjit për banim social, pas kryerjes së studimit të fizibilitetit nga Banka Botërore dhe UNHABITAT.

Gjithashtu, Ministria e Pushtetit Lokal ka iniciuar ndryshimin e Projektligjit për Vetëqeverisjen Lokale përmes të cilit "Advancing Together" (AT) ka theksuar nevojën e fuqizimit të rolit të Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim, për sa i përket vendimmarrjes në nivel komunal, dhe përfshirjes së planeve të tyre në buxhetet e planifikuara të komunave.

Ka pasur konsultime publike lidhur me Projektligjin për regjistrimin e popullsisë dhe banesave. AT-ja ka kërkuar marrjen parasysh të numërimit të personave të zhvendosur, azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave pa shtetësi në numërimin e popullsisë.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit. Prioritetet kryesore janë parandalimi dhe lufta kundër krimit, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, si dhe përmirësimi i efikasitetit të organeve të drejtësisë.

Qeveria e Kosovës ka miratuar edhe Programin dhe Planin e Veprimit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut për 2021-2015.

Ministria për Komunitete dhe Kthim është në proces të finalizimit të Strategjisë së re për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. AT ka ofruar komente lidhur me legjislacionin, mekanizmat, çështjet pronësore, situatën pandemike, sigurinë, arsimin, integrimin socio-ekonomik e të tjera.

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) – Zyra e Kryeministrit është në proces të konsultimit publik me shoqërinë civile dhe autoritetet tjera lokale dhe qendrore për draft Strategjinë për Integrimin e komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Sipas nenit 7 të Rregullores Nr. 01/2018[1] për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, ZKKK-të janë përgjegjëse për hartimin e Planit të Veprimit Komunal. Vetëm 5 komuna kanë plane veprimi komunale për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, ndërsa 13 komuna janë në proces të hartimit të tyre.

## ZHVILLIMET INSTITUCIONALE (NIVEL LOKAL/QENDROR)

Në fillim të vitit, përkatësisht më 14 shkurt 2021 u mbajtën zgjedhjet parlamentare të Kosovës, ku si rrjedhojë pati ndryshim të pushtetit politik në Kosovë. Në fakt, ish-partia politike opozitare, Lëvizja Vetëvendosje, arriti të fitojë shumicën e vendeve në Kuvendin e Kosovës. Spektri politik serb nuk kishte pësuar ndryshime, kështu që "Srpska Lista" vazhdon të mbajë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Ministria e Pushtetit Lokal për herë të parë drejtohet nga një parti politike egjiptiane, përkatësisht "IRDK", e cila është në koalicion me "Lëvizjen Vetëvendosje". Të gjitha komunitetet vazhdojnë t'i mbajnë vendet e tyre të rezervuara në Kuvendin e Kosovës.

Në tetor dhe nëntor 2021 u mbajtën edhe zgjedhjet lokale për kryetarë të komunave dhe kuvende komunale. Nuk ka pasur ndryshime të mëdha në nivel lokal që mund të kenë ndikim në procesin e kthimit.

Në nivelin lokal, Komisioni Komunal për Kthim ka qenë aktiv vetëm në ato komuna ku zbatohet projekti i banimit "RRK V". Megjithatë, anëtarët e këtij Komisioni mbeten joaktiv në shqyrtimin e procesit të aplikimit, dhe kryesisht mbështeten në rekomandimet e kryetarëve të/ZKKK-ve dhe të partnerit zbatues. Tre komuna në pjesën veriore të Mitrovicës (Mitrovica Veriore, Zubin Potoku dhe Leposaviqi) ende nuk e kanë themeluar komisionin komunal për kthim.

Për shkak të situatës pandemike, ZKKK-të nuk ishin edhe aq aktive në kontaktimin e komuniteteve të të kthyerve dhe të zhvendosurve. Sipas Rregullores për ZKKK-të, kryetari i ZKKK-së sipas detyrës zyrtare duhet të ftohet nga kryetari i komunës në takimet me drejtorët komunalë. Megjithatë, vetëm në 10 nga gjithsej 38 komuna ata ftohen në takime të tilla, gjë që tregon një ndikim shumë të ulët të tyre në procesin e vendimmarrjes. Një shqetësim tjetër është financimi i projekteve të komunitetit përmes buxhetit të ZKKK-së, pasi vetëm 8 ZKKK kanë linjë buxhetore për

[1] https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/RREGULLORE_(QRK)_-_NR._01_-2018_P%C3%8BR_KTHIMIN_E_PERSONAVE_T%C3%8B_ZHVENDOSUR_DHE_BQN%

subvencione, ndërsa vetëm 5 për projekte kapitale në vitin 2021. Trend i ngjashëm është paraparë edhe me Buxhetin e Kosovës për vitin 2022 (9 subvencione/3 projekte kapitale). Shumica e komunave kanë treguar se projektet komunitare shpërndahen përmes buxhetit përkatës të departamenteve të tjera komunale.




## ASISTENCA HUMANITARE

Familjet e kthyera në mënyrë spontane përbënin vetëm 10 % nga numri i përgjithshëm i familjeve të kthyera të monitoruara. Ushtrimi zbuloi se vetëm dy të kthyer spontanë kanë përfituar nga ndihma me artikuj ushqimor/jo-ushqimor që ofrohet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Sipas nenit 13 dhe 14 të Rregullores për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhje të Qëndrueshme, të kthyerit mund të përfitojnë ndihmë tre mujore në paketë me produkte ushqimore dhe produkte jo ushqimore në rast se ata i përkasin kategorisë së personave shumë apo mesatarisht të cenueshëm.

Asnjë vlerësim i tillë i cenushmërisë  nuk është bërë nga Komisionet Komunale për Kthim, pasi që ZKKK-ja nuk i ka paraqitur Komisionit asnjë raport vlerësimi të gjetjeve pas regjistrimit të të kthyerve. Janë identifikuar vetëm dy raste, ku kryetari/ZKKK-së ka dorëzuar drejtpërdrejt kërkesë për pako me produkte ushqimore/joushqimore në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

Përfituesit e “BE-Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë-Faza V” dhe "Mbështetja e zgjidhjeve të qëndrueshme për banorët e qendrës kolektive në Kosovë” në Brezovicë, Shtërpcë dhe Bergen, Graçanicë kanë përfituar nga ndihma me produkte ushqimore/joushqimore.

## STREHIMI

Këtë vit janë ndërtuar gjithsej 41 shtëpi si pjesë e projektit të strehimit “BE-Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë- Faza V” (RRK V) dhe 15 shtëpi si pjesë e “Përballja me trashëgiminë e konfliktit në Kosovë dhe Serbi - Rezultati 2” (Këshilli Danez për Refugjatë). Në anën tjetër, në mungesë të mbështetjes nga programet e disponueshme për kthim, një familje PRE rome përfitoi ndihmë për strehim nga diaspora.

Përveç kësaj, BE-ja dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim bashkë-themeluan projektin “Mbështetja e zgjidhjeve të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë” në Brezovicë, komuna e Shtërpcës, i cili u zbatua nga Këshilli Danez për Refugjatë (KDR). Janë ndërtuar pesë (5) ndërtesa rezidenciale me 110 njësi banimi për personat e zhvendosur dhe familjet në nevojë.  Gjithsej 143 persona të zhvendosur serbë, kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme për strehim këtë vit përmes këtij projekti.

Gjithashtu, si pjesë e "Përkrahja e zgjidhjeve të qëndrueshme për banorët e qendrave kolektive në Kosovë Faza II", 21 persona serbë të zhvendosur brenda vendit në Bergen, Graçanicë kanë përfituar nga banesat sociale të rinovuara. Projekti është bashkëfinancuar nga BE-ja dhe MKK-ja dhe është implementuar nga KDR. Si pjesë e të njëjtit projekt, janë në proces procedurat e tenderimit për ndërtimin e dy ndërtesave të banimit edhe në komunën e Leposaviqit.

Gjithashtu, një person i zhvendosur shqiptar me banim në Qendrën Kolektive "DES" në Mitrovicën Jugore, ka përfituar një banesë nga një grup humanitar i grave.

Komisioni Qendror Shqyrtues është mbledhur për të shqyrtuar rastet që kanë të bëjnë me projektin e banimit "BE-Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë – Faza V" (RRK V), ku ka miratuar gjithsej 46 raste.

Sipas nenit 15.2 të Rregullores, të kthyerit dhe personat e zhvendosur mund të përfitojnë edhe nga qiraja si masë e përkohshme strehimi. Vetëm një i kthyer egjiptian në Gjakovë ka përfituar këtë vit nga një opsion i tillë, përmes buxhetit të ZKKK-së. Komunat kanë buxhet të kufizuar ose nuk kanë fare buxhet për të mbuluar skemën e qirave.

Vlen të theksohet se 44 familje rome, ashkali dhe egjiptiane që janë kthyer nga Maqedonia e Veriut vazhdojnë të përballen me sfida në realizimin e integrimit të qëndrueshëm dhe për momentin nuk kanë zgjidhje të qëndrueshme. Të gjitha këto familje të kthyera banojnë në akomodime private dhe për shkak të kushteve të tyre socio-ekonomike të këqija, ato nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot e qirasë dhe faturat e shërbimeve komunale, prandaj janë subjekt i presionit të vazhdueshëm nga pronarët e tyre për t'u dëbuar. Janë 52 familje të zhvendosura shqiptare që jetojnë me qira dhe 47 familje që jetojnë me të afërmit. Shumica e pronave të tyre në veri të Mitrovicës janë ende të uzurpuara dhe janë në procedurë të AKKVP-së. Janë edhe më shumë se 100 familje të zhvendosura serbe që jetojnë me qira ose tek të afërmit e tyre, të cilat akoma nuk kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme për strehim, për shkak të mungesës së fondeve për ndërtimin e shtëpive.

Kosova ka një kornizë të gjerë ligjore që është projektuar për të mbrojtur të drejtat pronësore. Në shkurt të vitit 2017, Qeveria e Kosovës ka lançuar Strategjinë e Kosovës për të Drejtat Pronësore që përcaktoi pesë objektiva kyçe të politikave, duke përfshirë forcimin e kornizës ligjore, adresimin e informalitetit në sektorin e pronës së paluajtshme dhe zbatimin e të drejtave pronësore të personave të zhvendosur dhe komuniteteve joshumicë. Megjithatë, miratimi i Strategjisë dështoi në përmirësimin e situatës së përgjithshme lidhur me të drejtat pronësore, dhe sfidat e vjetra vazhduan të ekzistonin.

Komunat ballafaqohen me posedim të kufizuar të tokës komunale dhe sfida legjislative në ndarjen e tokës komunale për kërkesa individuale. Ka komuna që kanë gjetur tokën komunale[2] për banesat e strehimit social ose kanë hartuar programin e strehimit social[3]. Janë gjithsej 95 familje të kthyera/të zhvendosura, pa tokë, kryesisht nga komunitetet romë, ashkali dhe egjiptianë.

Duhet theksuar se akoma ka raste kur e drejta në shfrytëzimin e pronës nuk është regjistruar në librat kadastral komunal, edhe pse ajo tashmë është përfituar nga ndarja e tokës komunale dhe ndihma për strehim, përmes projekteve të lehtësuara, p.sh. Mëhalla e Romëve, Mitrovica e Jugut, Gjakovë.

Uzurpimi ilegal i pronës, përfshirë uzurpimin e sërishëm të pronave të liruara, mbetet një nga sfidat më të mëdha për komunitetin serb të të kthyerve. Uzurpimi i tokës bujqësore në shumicën e rasteve është raportuar në policinë lokale të Kosovës por pa rezultate afatgjata dhe/ose mbrojtje nga sistemi i drejtësisë. Të kthyerit po përballen me vështirësi në qasjen në sistemin e drejtësisë së Kosovës, për shkak të mungesës së informacionit dhe mungesës së avokatëve dhe gjyqtarëve serbë në shumicën e rajoneve, edhe pas riintegrimit të tyre në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Procedurat e gjata gjyqësore, dështimet në njoftimin e palëve dhe cilësia e dobët e përkthimit në gjuhën serbe, e pengojnë komunitetin serb që lirshëm të ushtroj dhe mbrojë të drejtat e veta pronësore.

[2] Gjakovë, Prishtinë

[3] Fushë Kosovë, Pejë, Gjilan, Gjakovë, Mitrovicë e Jugut

Pak komuna kanë ndërmarrë iniciativën për të zhvilluar koncept dokumente mbi zgjidhjet e qëndrueshme të strehimit dhe integrimin socio-ekonomik të të kthyerve/personave të zhvendosur. Komunat e Prishtinës, Novobërdës dhe Gjilanit tashmë i kanë miratuar dokumentet e tilla, ndërsa Komuna e Gjakovës është në proces të finalizimit të tyre. Koncept dokumentet, përveç komponentëve të riintegrimit socio-ekonomik, kanë futur edhe aspektin e strehimit social, për të mbështetur të kthyerit/familjet e zhvendosura që nuk kanë tokë, dhe ato që nuk mund të kthehen në vendin e origjinës. Këto iniciativa duhet të mbështeten përmes aktiviteteve për mbledhjen e fondeve dhe inkorporimit në buxhetet komunale dhe ato të ministrive përkatëse.

## QASJA NË TË DREJTAT DHE SHËRBIMET

Një numër i kufizuar (38) i të kthyerve dhe personave të zhvendosur vazhdojnë të përballen me sfida/pengesa gjatë procesit të marrjes së dokumenteve të gjendjes civile. Fëmijët që lindin jashtë institucioneve dhe të cilëve u mungon dokumentacioni i prindërve, kanë vështirësi për të fituar identitetin ligjor dhe të gëzojnë të drejtat e tyre në raport me qasjen e të drejtave dhe shërbimeve. Përveç kësaj, martesat e hershme dhe krijimi i familjeve të reja nga prindërit pa dokumente të Kosovës paraqet një tjetër problematikë. Ka probleme të tjera që e ndikojnë negativisht regjistrimin e fëmijëve pas lindjes, siç është mungesa e dokumenteve nga vendi i origjinës (nëna), gabimet teknike në dokumente krahasuar me me të dhënat në librat e gjendjes civile.

Ka raste të tjera kur familjet nuk kanë qasje ndaj të drejtave dhe shërbimeve, pasi bashkëshortët e tyre kanë probleme për të siguruar lejen e qëndrimit dhe për të nisur procedurat e natyralizimit përmes martesës. Arsyeja është se këtyre individëve u mungon dokumentacioni i duhur nga vendi i tyre i origjinës, u mungojnë mjetet financiare për të mbuluar shpenzimet e transportit, si dhe, u mungon informacioni mbi rregullat dhe procedurat.

Të kthyerit e moshuar dhe personat me nevoja të veçanta ballafaqohen me pengesa në fillimin e procedurave për aplikim për pension bazë/invalidor, për shkak të mungesës së dokumentacionit personal, mungesës së vërtetimit të vendbanimit (qira joformale/lëvizjet e shpeshta), mungesë njohurish për institucionet publike/lokacionin për kontrollime mjekësore dhe për rregullimin e dokumentacionit të nevojshëm për procesin e aplikimit.

Për më tepër, prindërit kanë një nivel të ulët njohurish mbi procedurat dhe/ose për adresimin e kërkesave për të drejtat e tyre. Rregullimi i dokumentacioneve të tilla përfshin kosto financiare, kështu që për shkak të situatës së tyre të vështirë ekonomike, PSh-të nuk ndërmarrin veprime përkatëse, kështu që nuk mund të aplikojnë për asistencë sociale ose përfitime të tjera sociale.

Përveç kësaj, është vërejtur një njohuri e kufizuar në lidhje me Sistemin e Drejtësisë së Kosovës, Zyrën Komunale për të Drejtat e Njeriut, Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas dhe rolin e Ombudspersonit.




Rastet e identifikuara që kanë nevojë për ndihmë juridike: **267**

## QASJA NË SHËRBIMET SHËNDETËSORE

Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë, i cili parasheh mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të të gjithë njerëzve në Kosovë, përcakton shprehimisht se zbatimi i tij duhet të jetë në përputhje të plotë me standardet dhe parimet e garantuara të të drejtave të njeriut. Ai përcakton se ofrimi i kujdesit shëndetësor duhet të sigurojë, midis parimeve të tjera kyçe, barazi të plotë në qasje, gjithëpërfshirje dhe mosdiskriminim, si dhe cilësi në shërbime.

Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor krijon një sistem të detyrueshëm publik të sigurimit shëndetësor universal për të siguruar qasjen e të gjithë njerëzve në Kosovë në kujdesin shëndetësor bazë, me qëllim të përmirësimit të treguesve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare përkundër kostove të larta të kujdesit shëndetësor. Megjithatë, ky ligji ende nuk është i detyrueshëm sepse ai akoma nuk është futur në zbatim.

Të kthyerit dhe personat e zhvendosur kanë qasje në shërbimet shëndetësore të administruara në Kosovë dhe në Serbi. Situata e pandemisë përkeqësoi dhe shfaqi sfidat që ekzistonin edhe më herët në lidhje me kapacitetet e kufizuara të sistemit shëndetësor të Kosovës, dhe gëzimin e të drejtës për shëndet për të gjithë njerëzit në Kosovë. Për shkak të paraqitjes së rasteve me COVID 19, shërbimet shëndetësore të natyrës jo emergjente në institucionet shëndetësore sekondare dhe terciare u pezulluan përkohësisht (mars/prill dhe gusht 2021), pasi qëllimi i sistemit shëndetësor ishte i fokusuar në parandalimin dhe trajtimin e pacientëve të infektuar me COVID 19, prandaj qytetarët me probleme të tjera shëndetësore dhe me sëmundje kronike, nuk kanë marrë shërbimet e nevojshme shëndetësore që garantohen me ligjin në fuqi.

Ka fëmijë që nuk kanë marrë vaksinat e tyre rutinore pasi sistemi shëndetësor është mbingarkuar. Për më tepër, shumë nga prindërit nuk kanë njohuri për vaksinat e fëmijërisë dhe përfitimet e tyre. Ka edhe shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në qëndrimin e prindërve, por nuk kufizohen vetëm në to, si për shembull: frika nga efektet anësore, mungesa e transportit, analfabetizmi, angazhimi në punë "në të zezë"e të tjera. AT ka identifikuar 43 fëmijë që nuk janë imunizuar, kryesisht nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Gjithashtu, të moshuarit e kthyer, për shkak të moshës dhe distancës së largët të shërbimeve shëndetësore, shpeshherë privoheshin nga kontrolli i rregullt mjekësor, gjegjësisht matja e presionit të gjakut, kështu që gjendja e tyre shëndetësore ishte gjithmonë në rrezik.

Përtej pasojave të dukshme për shëndetin fizik dhe të drejtën për jetë, pandemia dhe masat e lidhura me të ndikuan negativisht edhe në të drejtën për shëndetin mendor. Masat kufizuese, si dhe ndikimi i pandemisë në situatën socio-ekonomike dhe pasiguria e përgjithshme për të ardhmen, çuan në rritje të niveleve të problemeve të shëndetit mendor (ankth/çrregullime të gjumit) dhe dhunë në familje. Janë 23 të kthyer që kanë marrë trajtim psikosocial për shkak të problemeve të lidhura me COVID 19.

Për shkak të statusit të tyre të dobët socio-ekonomik, jetesës në varfëri dhe kushteve të papërshtatshme të banimit, mungesës së mjeteve mbrojtëse, pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian ishin në rrezik më të madh për t'u infektuar me COVID 19. Kompetenca digjitale ishte një pengesë për të hyrë në platformën online të vaksinimit kundër COVID-19, pasi shumë prej tyre (43) nuk kishin qasje në internet, pajisje elektronike ose kishin aftësi dhe kompetencë më të ulët dixhitale. Përveç kësaj, ishte identifikuar edhe ngurrimi ndaj vaksinës si një shqetësim mbrojtës në këtë grup, për shkak të informacionit të rremë/teorive konspirative të përhapura në mediat sociale.

Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Pushtetit Lokal, ka dërguar një ekip mobil në vendbanimet kryesore të komuniteteve në komunat e Gjakovës, Prizrenit, Fushë Kosovës, Pejës, Mitrovicës Jugore dhe Prizrenit, ku u imunizuan gjithsej 1700 individë. Të kthyerit nga Serbobrani i Istogut kanë refuzuar dy herë ekipet mobile shëndetësore për vaksinim kundër COVID 19, për shkak të frikës nga efektet anësore dhe dezinformatave në rrjetet sociale.

Në anën tjetër, institucionet e Shëndetësisë të Serbisë kanë organizuar transport të organizuar me autobus për të kthyerit serbë dhe personat e zhvendosur brenda Serbisë. Megjithatë, ka raste kur të kthyerit e moshuar serbë, që

banojnë në banesat sociale në Shtërpcë, për shkak të moshës dhe gjendjes së tyre shëndetësore, nuk kanë mundur të përballojnë udhëtimin për në Serbi, kështu që mbeten të pavaksinuar.




Nga ana tjetër, pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të përballen me vështirësi për të mbuluar shpenzimet e barnave, për shkak të gjendjes së tyre të rëndë ekonomike. Të gjithë të kthyerit serbë kanë sigurim shëndetësor nga Serbia, ndërsa të kthyerit e tjerë nga etni të ndryshme nuk kanë sigurim shëndetësor. Më e rëndësishmja, Ligji Nr. 04/L-249 për Sigurimet Shëndetësore ende nuk është zbatohet për më shumë se shtatë vite që nga miratimi i tij fillestar.

Sëmundjet si ato kardiovaskulare (4), diabetike (4), mendore (4), kanceri (2) ishin problemet shëndetësore që po preknin të kthyerit. Janë dy individë me nevoja të veçanta që kanë të bëjnë me dëmtimet e të folurit dhe dëgjimit.

Ekziston një trend në rritje i keqpërdorimit të narkotikëve nga të kthyerit, veçanërisht në vendbanimet më të mëdha (Ali Ibra, Gjakovë, Plemetin, Obiliq, Serbobran, Istog). Keqpërdorimi ka të ngjarë të lidhet me mungesën e aktiviteteve sociale dhe kushteve të këqija të jetesës. Ky fenomen po shkakton dhunë në familje, përleshje fizike dhe çfarë është më shqetësuese, tentativat për vetëvrasje, 1 rast.

Sa i përket informacionit për shëndetin riprodhues, para dhe pas lindjes, familjet e të kthyerve në mbarë Kosovën nuk kanë udhëzime se ku mund të kenë qasje në këtë lloj informacioni.

## INTEGRIMI SOCIO EKONOMIK

Shkalla e papunësisë në mesin e familjeve të kthyera mbetet shumë e lartë. Vetëm 77 nga 276 individë të rritur kanë gjetur punë ose vetëm 27%.




Mungesa e arsimimit dhe mungesa e aftësive profesionale i përjashton të kthyerit nga angazhimi në një punësim të rregullt dhe të denjë. Ka edhe pengesa për punësimin në sektorin publik të cilat ndërlidhen me kriteret e kërkuara të arsimit adekuat dhe përvojës së mëparshme të punës të cilën ata nuk e kanë.

Të kthyerve u mungojnë aftësitë dhe interesi për të ndjekur trajnime profesionale, nëse shpenzimet e tyre të udhëtimit nuk mbulohen ose nëse ata nuk paguhen, gjë që lidhet me nivelin e ulët të ndërgjegjësimit për rëndësinë e punësimit të rregullt. Përveç kësaj, ata ballafaqohen me sfida për t'iu qasur granteve online, për shkak të mungesës së njohurive mbi përdorimin e teknologjisë dhe sistemit online, mungesës së njohurive për hartimin e projekt-propozimeve për të aplikuar në thirrjet që bën qeveria dhe për grantet që ofrohen nga OJQ-të. Frika nga humbja e përfitimit të ndihmës sociale nëse punësohet në mënyrë të rregullt, dhe preferenca për të lidhur një kontratë pune joformale për të njëjtën arsye, është një tjetër faktor që po ndikon në vendimin e tyre për të aplikuar për punësim formal. Për disa gra të kthyera, kryesisht nga komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, për shkak të roleve të caktuara gjinore, frikës nga ngacmimi seksual ose për shkak se ndihen ndonjëherë të pasigurta jashtë lagjes së tyre, ngushtohet fokusi i tyre gjeografik për të kërkuar një punë.

Një numër i serbëve të kthyer janë të angazhuar në aktivitete bujqësore dhe shumica e tyre janë në gjendje të prodhojnë për konsum vetjak. Mungojnë stimujt/grantet/pajisjet për t'u mundësuar atyre të rrisin prodhimin e tyre. Subvencionet e disponueshme që ofron qeveria janë shpesh të paarritshme, për shkak të mungesës së informacionit dhe dokumentacionit të pronës, për shkak të mos zgjidhjes së çështjes së trashëgimisë. Një numër i serbëve të kthyer kryesisht i shesin prodhimet e tyre në zonat e banuara me serbë, pasi nuk kanë qenë në gjendje të krijonin lidhje me tregtarët/tregun vendor.




## ARSIMI

Kushtetuta e Kosovës, neni 47 mbi të Drejtën për Arsimim thotë: "Çdo person gëzon të drejtën e arsimit bazë falas. Arsimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike; Institucionet publike duhet të sigurojnë mundësi të barabarta për arsimim për të gjithë në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike", ndërsa neni 59.2 deri në 59.4 nën "Të drejtat specifike arsimore për pakicat" përcakton se: "Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, individualisht ose në bashkësi, që: të arsimohen në njërën nga gjuhët zyrtare sipas zgjedhjes së tij/saj; marrin arsimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre në masën e përcaktuar me ligj".

Gjithashtu, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 03/L-047[4] i ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-020, në nenin 8 për të drejtat e komuniteteve në arsim thuhet: "Të ofrojë arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm publik në njërën nga gjuhët zyrtare të zgjedhura nga komunitetet ose në gjuhën e tyre amtare, edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare. Të sigurohet që kurrikulat dhe tekstet shkollore mbulojnë historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve"

[4] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2531

Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar[5] është ligji bazë që rregullon sistemin arsimor parauniversitar në Kosovë. Ligji parashikon se "asnjë personi nuk do t'i mohohet e drejta për arsimim" dhe kërkon që MASHT-i të marrë parasysh gjatë planifikimit, menaxhimit dhe realizimit të arsimit parauniversitar, normat e pranuara ndërkombëtarisht, të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve në situata të cenueshme, dhe promovimin e barazisë gjinore.

Për më tepër, në përputhje me nenin 5, Ligji për Arsimin Parashkollor (ligji nr. 02/L-52[6]) përcakton se në vendet me popullsi të përzier, autoritetet përkatëse duhet të ofrojnë arsim parashkollor në gjuhët e pakicave, në përputhje me ligjin.

Arsimi është faktori më i rëndësishëm dhe më i qëndrueshëm në parandalimin e varfërisë dhe integrimin social. Dihet mirë se personat e paarsimuar ose ata që e nisin shkollimin e tyre një fazë të mëvonshme, ose që e lënë shkollimin herët, përballen me vështirësi për t'u punësuar dhe, në përgjithësi, mundësitë e tyre në jetë janë të kufizuara.

Shumë prej të kthyerve vullnetarë nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian përballen me sfida, përfshirë ato që lidhen me të drejtën për arsimim. Pas një periudhe të gjatë të jetesës si të zhvendosur, shpesh në kushte të palakmueshme, të kthyerit shpesh e kanë të vështirë procesin e kthimit dhe riintegrimit. Nivel i ulët i arsimimit dhe analfabetizëm vërehen tek romët, ashkalitë dhe egjiptianët, edhe pse arsimi fillor në Kosovë është i detyrueshëm. E drejta për arsim rrezikohet nga varfëria e rëndë, pasi studentët dhe prindërit e tyre përpiqen të përballojnë furnizimet e nevojshme për ndjekjen e rregullt të shkollës.

Janë 10 % nga numri i përgjithshëm i të kthyerve të rritur, të cilët janë analfabetë, kryesisht nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian; 10 % kanë diplomë universitare, 49 % kanë arsim të mesëm dhe 31 % kanë vetëm arsim fillor. Tabela e mëposhtme tregon se komuniteti serb i të kthyerve ka nivel më të lartë arsimor në krahasim me komunitetet tjera.

| **Arsimimi** | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përkatësia etnike | Universiteti | | E mesme | | Fillore | | Analfabet | |
| | M | F | M | F | M | F | M | F |
| Boshnjakë | | | | | | 1 | 0 | 0 |
| Shqiptarë | 0 | 0 | 3 | 4 | 0 | 2 | 0 | 1 |
| Ashkali | 0 | 0 | 2 | 0 | 6 | 5 | 3 | 6 |
| Egjiptian | 0 | 0 | 2 | 2 | 5 | 9 | 1 | 3 |
| Romë | 0 | 0 | 2 | 2 | 9 | 9 | 4 | 4 |
| Serbë | 17 | 26 | 98 | 85 | 32 | 44 | 5 | 11 |
| **Gjithsej** | **17** | **26** | **107** | **93** | **52** | **70** | **13** | **25** |

Zhvillimi i hershëm në fëmijëri gjithashtu mbetet një sfidë e veçantë. Kopshtet publike janë të vendosura kryesisht në qytete, të cilat janë shumë larg vendit të kthimit (distanca mesatare 5-8 km). Faktori tjetër kryesor për mos dërgimin e fëmijëve të tyre në çerdhe është varfëria dhe mungesa e vetëdijesimit për përfitimet e arsimit parashkollor, ndaj ata vendosin të kujdesen vetë për fëmijët e tyre. Asnjë nga 25 fëmijët e monitoruar, nuk shkon në sistemin e arsimit parafillor.

Prindërit pohojnë se për shkak të kushteve të këqija ekonomike për sigurimin e veshjes së duhur, materialeve shkollore dhe shpenzimeve të transportit, fëmijët nuk e ndjekin rregullisht procesin arsimor, 19 raste, ose kanë braktisur procesin arsimor, 21 raste. Gjithashtu, ka akoma raste që prindërit përballen me vështirësi në regjistrim, për shkak të mungesës së dokumentacionit, 10 raste.

[5] https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770

[6] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2401

Ka raste të ngacmimeve të fëmijëve brenda dhe jashtë ambienteve të shkollës, duke ndikuar kështu në mentalitetin e fëmijëve për të vazhduar edukimin e rregullt.

Për shkak të situatës pandemike, një numër shkollash u detyruan të ofrojnë arsim përmes programeve të mësimit në distancë - online, duke përjashtuar kështu një numër të të kthyerve nga procesi arsimor, 29 raste. Për shkak të gjendjes së tyre të keqe ekonomike, ata nuk kishin qasje në internet ose nuk posedonin pajisje elektronike.

| **Frekuentimi i arsimit** | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përkatësia etnike | Univ. | | Shkolla e mesme | | Shkolla fillore | | Universiteti serb | | Shkolla e mesme serbe | | Shkolla fillore Serbe | | Braktisja | | Mosregjistrimi. | | Parashkollor | | Jo në kopsht fëmijësh | |
| | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F |
| Boshnjakë | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ashkali | | | | | | | | | | | | | 5 | 3 | 2 | 1 | | | 1 | |
| Egjiptianë | | | 1 | 1 | 1 | | | | | | | | 3 | 2 | 1 | 1 | | | 2 | 1 |
| Romë | | | 1 | 2 | 3 | 2 | | | 2 | 1 | | | 6 | 2 | 2 | 3 | | | 1 | 2 |
| Serbë | | | | | | | 2 | 1 | 5 | 4 | 6 | 8 | | | | | | | 3 | 1 |
| Shqiptarë | 1 | 1 | 2 | 2 | 1 | 1 | | | | | | | | | | | | | | |
| **Gjithsej** | **1** | **1** | **4** | **5** | **5** | **3** | **2** | **1** | **7** | **5** | **6** | **8** | **14** | **7** | **5** | **5** | | | **7** | **4** |

## MBROJTJA E FËMIJËVE

Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve[7] ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2020. Ligji mundëson zbatimin e plotë të Kushtetutës së Kosovës dhe Konventës drejtpërdrejte të aplikueshme mbi të Drejtat e Fëmijëve, me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna fizike dhe mendore, abuzimi, shfrytëzimi, neglizhenca dhe forma të tjera të dhunës që rrezikojnë jetën, sigurinë, shëndetin, arsimimin ose zhvillimin e tyre.

Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve mbetet i copëzuar si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, dhe i mungon një qasje efektive për të adresuar shqetësimet e mbrojtjes. Për shkak të sfidave të riintegrimit, familjet që përballen me varfërinë dhe papunësinë, thjesht nuk kanë interes të njoftohen me të drejtat e fëmijëve. Fëmijët shfrytëzohen si lypsarë rruge, grumbullim të lëndëve të para për të krijuar të ardhura për familjet, kështu që detyrohen të ndërpresin arsimin ose të mos ndjekin rregullisht arsimin. Janë 59 fëmijë të kthyer që janë përfshirë në punë në forma të ndryshme.

Edhe pse në rënie, martesat e hershme, 3 raste, janë të zakonshme dhe vazhdojnë të praktikohen në këto komunitete. Një ndër faktorët që shtyn drejt martesës së hershme është gjendja e tyre e keqe ekonomike. Për shkak të traditës së tyre, shpesh martesat e hershme nuk raportohen në qendrën për punë sociale, ndërsa policia dhe prokurorët e Kosovës jo gjithmonë detyrojnë zbatimin e ligjin, duke ia atribuar martesën e fëmijëve normave kulturore. Mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve nuk funksionojnë siç duhet, si dhe nuk ka linja koordinimi ndërmjet prindërve, shkollave dhe Qendrës për Punë Sociale për të parandaluar këtë fenomen. Martesat e hershme pasohen me dhunë në familje, dëmtime fizike dhe psikologjike, pengesa për zhvillimin e duhur të fëmijës dhe pengesa për një jetë dinjitoze.

[7] https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844

## LIRIA E LËVIZJES, SIGURIA DHE SIGURIA PERSONALE

Klima politike e Kosovës, dialogu Prishtinë-Beograd, si dhe përkeqësimi i gjendjes socio-ekonomike të të gjitha komuniteteve, janë disa nga faktorët që shkaktuan rritjen e numrit të incidenteve të sigurisë. Periudha për të cilën është bërë vlerësimi u karakterizua me një numër të madh të sulmeve kundër objekteve të kultit, sulme fizike, frikësime, vjedhje dhe dëmtime pronësore.

Nga 1 janari deri më 31 tetor 2021, janë regjistruar 31 incidente në mbarë Kosovën që përfshinin komunitetet joshumicë të të kthyerve/personave të zhvendosur. Kishte 22 incidente të tjera që në mënyrë të tërthortë kishin ndikim në personat nën shqetësimin (Psh) të UNHCR-së, përkatësisht njëmbëdhjetë (11) incidente të ndërlidhura me sulmet kundër objekteve të kultit, gjashtë (6) sulme, (3) frikësime dhe dy (2) dëmtime të pronës.

Të kthyerit serbë vazhdojnë të jenë cak i vjedhjeve, i gjuajtjes me gurë, dëmtimeve pronësore dhe frikësimeve, duke krijuar kështu perceptim negativ për situatën e sigurisë dhe që kjo është me ndikim në procesin e pajtimit. Të kthyerit serbë thonë se shumica e rasteve mbeten të pazgjidhura dhe nuk ka përgjigje të rregullta nga policia për statusin e rastit.






Kthimi spontan individual në zonën e pikave të nxehta, pa koordinimin e aktorëve përkatës të kthimit, po rezulton të jetë një praktikë shumë sfiduese. Kthimi i fundit në njërën nga komunat e Kosovës, ka shkaktuar reagimin e komunitetit lokal, i cili publikisht e kundërshtoi një kthim të tillë nga frika e kthimit të mundshëm në të ardhmen në këtë zonë. Situata u pasua me incidente sigurie dhe refuzim të tregut vendor për t'i shitur produkte personit të kthyer. Gjithashtu, autoritetet komunale kanë nisur procedura gjyqësore për kontestimin e të drejtave të saj pronësore, duke vonuar kështu procesin e riparimit të vogël të objektit banues.

Për shkak të situatës politike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Mitrovicës, personat e zhvendosur shqiptarë kanë perspektivë të kufizuar për t'u kthyer në vendin e origjinës. Gjithashtu, në këtë zonë nuk ka mundësi punësimi, kështu që ata janë të detyruar të punojnë në pjesën jugore.

Në komunat e Klinës (Krushevë e Madhe) dhe Istogut (Gurakoc) ka pasur aktivitete për ndërtimin e besimit ndërmjet komunitetit pranues dhe atij të kthyer, që çon në zhvillimin e projekteve me bazë në komunitet, si dhe në procesin e pajtimit.

Faktorët që ndërlidhen me situatën pandemike, kushtet e këqija ekonomike, abuzimi me alkoolin dhe drogën, kanë sjellë rritjen e dhunës në familje. Të gjitha këto shkaktuan simptoma ankthi dhe depresioni të raportuara nga shumica e rasteve. Përgjegjshmëria

për mbrojtjen nga dhe parandalimin e dhunës në familje nuk funksionon siç duhet dhe nuk ka një sistem të duhur përcjellës/referimi. Faktor shqetësues është niveli i ulët i raportimit. Arsyeja për mos raportimin e rasteve mund të jetë sepse PSh nuk kanë qasje në informata, përkatësisht mund të mos posedojë numrat e kontaktit të Policisë së Kosovës, Qendrave për Punë Sociale dhe Shtëpive të Sigurta. Përveç kësaj, ata mund të jenë nën presion të vazhdueshëm fizik/psikologjik për të mos raportuar rastin.

## QASJA NË SHËRBIMET KOMUNALE

Të gjitha familjet e kthyera kanë qasje në shërbimet komunale në vendin e tyre të kthimit. Të kthyerit/personat e zhvendosur nuk janë në dijeni të mekanizmave dhe procedurave ankimore në rast të diskriminimit të tyre në ofrimin e shërbimeve publike.

Ka ende disa zona që ballafaqohen me probleme sanitare si Serbobrani, Istog, Plemetini, Obiiq, Ali Ibra dhe Brekoci, Gjakovë, Mahalla e Romëve, Mitrovicë e Jugut, Halit Ibishi dhe Dubravë, Ferizaj, 7 Shtatori dhe Nakelli, Komuna e Pejës.

Ka edhe zona që gjatë verës kanë probleme me shtypje të ulët të ujit si Levosha, Nakelli dhe Brestoviku - Komuna e Pejës, Serbobrani, Oprashka, Koshi - Istog, Binxha, Grapci dhe Klinafci, Klinë, Plemetini, Obiiq, Berivojce, Kamenicë, Levoshi dhe Novobërda.

**Mbështetur nga:**
**Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR në Prishtinë**

**Krijuar nga:**
**Advancing Together**